## SHTOJCA I

## SISTEMI I NGJYRAVE PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR

Grumbullimi i diferencuar i rrymave të tjera të mbetjeve që nuk janë ambalazhe, si letër, karton, qelq, metale, plastikë, tekstile dhe mbetje shtëpiake të përziera kryhet në mjete të posaçme, të identifikueshme me ngjyrat e mëposhtme:

| **Fraksioni** | **Ngjyra (minimal)** | **Përmbajtja** | **Shënime** |
|---|---|---|---|
| Letër dhe karton | ● Blu | Letër zyre, gazeta, revista, karton, ambalazhe kartoni | Kod minimal i detyrueshëm |
| Plastika Metale | ● E verdhë | Shishe PET, ambalazhe plastike të forta dhe fleksibël<br>Kanaçe alumini, ambalazhe metalike | Mund të ndahet me metale ose veç plastike<br>Kod i kombinuar me plastikën ose veç |
| Qelqi | ● Jeshile | Shishe qelqi, kavanozë | Për riciklim |
| Mbetje bio | ● Kafe | Mbetje ushqimore, mbetje kopshti | Për kompostim |
| Mbetje të përziera | ●/○ Gri/Zezë | Mbetje të përziera | Nuk riciklohet, shkon në landfill |
| Mbetje shtëpiake të rrezikshme | E kuqe | Mbetje nga bojëra, llakra, tretës, ngjitës, pesticide shtëpiake, produkte pastrimi me përmbajtje të rrezikshme, acide dhe baza, ambalazhe të kontaminuara me substanca të rrezikshme, aerosole, termometra me merkur, llamba fluoreshente | Nuk riciklohen |

*1 Ky vendim është përafruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.*

## SHTOJCA 2

## KALENDARI I GRUMBULLIMIT TË DIFERENCUAR TË MBETJEVE

Kalendari për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve letër, karton, qelq, metale, plastikë, tekstile dhe mbetje shtëpiake të përziera i cili plotësohet dhe përditësohet nga bashkia, ka përmbajtjen si më poshtë:

| MUAJI | DITA | ORA | FREKUENCA | ZONA E GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE | LLOJI I MBETJEVE |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

*1 Ky vendim është përafruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.*

**Direktiva 2008/98/KE (Tabelë përputhshmërie)**

| Direktiva 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 "Mbi mbetjet", e cila shfuqizon disa direktiva | | Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit)<br><br>"Projektvendimi për miratimin e kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve" (Projektvendim)<br><br>*Përputhshmëri e plotë* | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| Neni | Teksti | Referenca | Sesioni | Teksti | Përputhshmëria | Shënime |
| *10 (2)* | 2. Kur është e nevojshme për të përmbushur parashikimin e paragrafit 1 dhe për të lehtësuar ose përmirësuar përgatitjen për ripërdorim, riciklimin dhe operacionet e tjera të rikuperimit, mbetjet duhet të jenë subjekt i grumbullimit të diferencuar dhe nuk duhet të përzihen me mbetje të tjera ose materiale të tjera me karakteristika të ndryshme. | *Projektvendimi* | *I (1), (2)* | *Kreu I*<br>**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**<br><br>1. Objekti i këtij vendimi është miratimi i kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve, me qëllim lehtësimin ose përmirësimin për përgatitjen për ripërdorim, riciklim dhe operacioneve të tjera të rikuperimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rrymat e mbetjeve.<br><br>2. Grumbullimi i diferencuar i rrymave të mbetjeve kryhet nga zotëruesit e mbetjeve, në mënyrë të tillë që të garantohet:<br>a) parandalimi i përzierjes së rrymave të mbetjeve, me qëllim ripërdorimin, riciklimin dhe operacionet e tjera të rikuperimit,<br>b) parandalimi i ndotjes së mjedisit dhe çdo ndikimi negativ në shëndetin e njeriut. | E plotë | Dispozitat e projektligjit e përmendin disa herë se mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, megjithatë detyrimi nuk hyn në fuqi me miratimin e ligjit, por me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave që ka përcaktuar mes të tjerash afatin kur nis detyrimi. Kreu I (1), (2) i projektvendimit janë në përputhje të plotë me nenin 10 (2) të direktivës 2008/98/KE për mbetjet. |
| *11 (1)*<br>*Paragrafi 2* | Shtetet Anëtare do të marrin masa për të promovuar riciklimin e cilësisë së lartë dhe, për këtë qëllim, në përputhje me Nenin 10(2) dhe (3), do të bëjnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve. | *Projektvendimi* | *I (1), (2)* | *Kreu I*<br>**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**<br><br>1. Objekti i këtij vendimi është miratimi i kritereve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve, me qëllim lehtësimin ose përmirësimin për përgatitjen për ripërdorim, riciklim dhe operacioneve të tjera të | E plotë | Dispozitat e projektligjit e përmendin disa herë se mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, megjithatë detyrimi nuk hyn në fuqi me miratimin e ligjit, por me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave që ka përcaktuar mes të tjerash afatin |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | rikuperimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rrymat e mbetjeve.<br><br>2. Grumbullimi i diferencuar i rrymave të mbetjeve kryhet nga zotëruesit e mbetjeve, në mënyrë të tillë që të garantohet:<br>a) parandalimi i përzierjes së rrymave të mbetjeve, me qëllim ripërdorimin, riciklimin dhe operacionet e tjera të rikuperimit,<br>b) parandalimi i ndotjes së mjedisit dhe çdo ndikimi negativ në shëndetin e njeriut. | | kur nis detyrimi. Kreu I (1), (2), i projektvendimit janë në përputhje të plotë me nenin 10 (2) të direktivës 2008/98/KE për mbetjet. |
| *11 (1) Paragrafi 3* | Në përputhje me Nenin 10(2) dhe (3), Shtetet Anëtare do të bëjnë grumbullim të diferencuar të paktën për letrën, metalin, plastikën dhe qelqin, dhe deri më 1 Janar 2025, për tekstilet. | *Projektvendimi* | *IV (1)* | *Kreu IV*<br>**AFATET PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR**<br>1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masat e nevojshme për grumbullimin e diferencuar:<br>a) për mbetjet e përziera brenda vitit 2027<br>b) për mbetjet tekstile brenda vitit 2028<br>c) për mbetjet e vëllimshme brenda vitit 2028<br>ç) për mbetjet nga ndërtimi dhe shembja brenda vitit 2028<br>d) për mbetjet nga anijet dhe nga ngarkesat brenda vitit 2028<br>dh) për mbetjet nga gomat e përdorura brenda vitit 2028<br>e) për mbetjet letër, karton, qelq, metale, plastikë deri më 31.12.2030, të arrihen të paktën këto nivele minimale të riciklimit:<br>i. 50% plastikë;<br>ii. 70% metale;<br>iii. 70% qelq;<br>iv. 75% letër/karton;<br>ë) Për mbetjet letër, karton, qelq, metale, plastikë më 31.12. 2035, të arrihen këto nivele minimale riciklimi sipas rrymave:<br>i. 55% plastikë;<br>ii. 80% metale;<br>iii. 75% qelq;<br>iv. 85% letër/ karton<br>f) deri më 31.12. 2030, minimumi 65% të peshës së të gjitha mbetjeve të ambalazheve të riciklohet<br>g) deri më 31.12. 2035, minimumi 70% të peshës së mbetjeve të ambalazheve të riciklohet; | E plotë | Dispozitat e projektligjit e përmendin disa herë se mbetjet grumbullohen në mënyrë të diferencuar, megjithatë detyrimi nuk hyn në fuqi me miratimin e ligjit, por me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave që ka përcaktuar mes të tjerash afatin kur nis detyrimi. Kreun IV i projektvendimit është në përputhje të plotë me nenin 10 (2) të direktivës 2008/98/KE për mbetjet. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gj) deri më 31.12.2027, të grumbullohet minimumi 63% të mbetjeve nga bateritë dhe deri më 31.12.2030, të grumbullohet minimumi 73% të mbetjeve nga bateritë<br>h) deri në vitin 2028, të grumbullohen minimumi 50% të mbetjeve nga vajrat e përdorura, deri në vitin 2032, të grumbullohen minimumi 65% të mbetjeve nga vajrat e përdorura dhe deri në vitin 2025, të grumbullohen minimumi 75% të mbetjeve nga vajrat e përdorura.<br>i) deri më datë 31.12.2027, të grumbullohen minimumi 45% të mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike. | | |